



---

Adresa: Blvd. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri.  
Tel. 04-222-54-88, [www.artacademy.al](http://www.artacademy.al)

Nr. 54 prot.

Tiranë, më 17.01.2011

**Për:** Agjencinë e Prokurimit Publik

**Lënda:** Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

Rektorati i Akademisë së Arteve shpall konkursin për 3 (tre) vende të lira pune për personel akademik në Fakultetin e Muzikës si më poshtë:

- **FAKULTETI I MUZIKËS 3 (tre) vende**
  - **Punonjës mësimorë në lëndën Kitarë**
  - **Punonjës mësimorë në lëndën Klarinetë**
  - **Punonjës mësimorë në lëndët Lexim Partiture (ushtrime) dhe Instrumentacion - Orkestracion (ushtrime)**

Dokumentacioni që duhet të plotësojë çdo dosje e kandidatit duhet të përmbajë materialet e mëposhtme:

1. Kërkesë nga Kandidati ku të jetë përcaktuar vendi për të cilin ai konkuron;
  2. Diplomë origjinale + fletë notash ose fotokopje e noterizuar e Fakultetit ku ka kryer studimet dhe kualifikime të tjera pasuniversitare brenda dhe jashtë vendit (nota mesatare të jetë mbi 8.5 ose e ekuivalentuar me këto vlerë);
  3. Jetëshkrimi (CV) , ku të përfshihen veprimtaritë artistike dhe akademike brenda dhe jashtë vendit (e shoqëruar me dokumentacionin përkatës);
  4. Zotërimi i një gjuhe të huaj (e preferuar anglisht) me dëshmi të njohur nga MASH;
  5. Prezantimi i një projektprogrami për lëndën në të cilën ai konkuron;
  6. Dokumente që vërtetojnë përvojën në punë (fotokopje të librezës së punës);
  7. Kopje të letërnjoftimit ose kartës së identitetit;
  8. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
  9. Dëshmi e gjendjes mjeksore.
1. Konkurimi për punonjës mësimor për programin mësimor "Kitarë" dhe do të zhvillohet me tre faza si më poshtë:
- 1.1. Faza e parë - Shqyrtimi i dosjes së Kandidatit



- 
- 1.2. Faza e dytë - Provë interpretimi në Kitarë  
1.3. Faza e tretë - Mësim i hapur në Kitarë

**2. Konkurimi për punonjës mësimor për programin mësimor "Klarinetë" (speciale) dhe do të zhvillohet me tre faza si më poshtë:**

- 1.1. Faza e parë - Shqyrtimi i dosjes së Kandidatit  
1.2. Faza e dytë - Provë interpretimi në Klarinetë  
1.3. Faza e tretë - Mësim i hapur në Klarinetë (speciale)

**3. Konkurimi për punonjës mësimorë në lëndët Lexim Partiture (ushtrime) dhe Instrumentacion-Orkestracion (ushtrime) do të zhvillohet me katër faza si më poshtë:**

- 1.1. Faza e parë - Shqyrtimi i dosjes së Kandidatit  
1.2. Faza e dytë - Provë praktike e dijeve të Kandidatit në lëndën Lexim partiture.  
1.3. Faza e tretë - Provë me shkrim e dijeve të Kandidatit në lëndën Instrumentacion.  
1.4. Faza e katërt - Provë me shkrim e dijeve të Kandidatit në lëndën Orkestracion.

Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Degën e Burimeve Njerëzore të Akademisë së Arteve nga data **24. 01. 2011** deri më datë **02. 02. 2011** ora **14.00**.

Për datën e Konkursit kandidatët të informohen pranë Degës së Burimeve Njerëzore çdo ditë nga ora **08.00** deri **14.00**.

Për informacione të mëtejshme lidhur me përmbajtjen dhe programin e konkurrimit, kandidatët duhet ti drejtohen Sekretarisë së Fakultetit të Muzikës, çdo ditë nga **ora 08.00 deri në ora 14.00**

**Prof. Petrit MALAJ**

---

**REKTOR  
AKADEMIA E ARTEVE**